



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:253051
Datë: 14.12.2023
Numri i dokumentit: 05063467

C-IV.-14-5435

Ankuesi

F M, Fshati V, Rahovec.

kundër

E paditura

N.SH “NBI Rahoveci” (në likuidim), e përfaqësuar nga
Agjencia Kosovare e Privatizimit, (AKP) Rr. “Driton Hoxha”, nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Shkelzen Sylaj, me 14 dhjetor 2023, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa e ankuesit dhe ndryshohet Vendimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit – Autoriteti i Likuidimit, nr. PRZ011-1037, i datës 31 mars 2014.**
- II. Obligohet AKP– Autoriteti i Likuidimit të N.SH-së në likuidim, që në emër të dëmshpërblimit për ndërprerjeje të parakohshme të kontratës së punës, t’ia paguaj ankuesit F M shumën prej 750.00 €, sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj.**
- III. Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Më 16 korrik 2014, ankuesi përmes postës dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit nr. PRZ011-1037, të datës 31 mars 2014, të Autoritetit të Likuidimit (tutje AL) më të cilin ka kërkuar dëmshpërblim për ndërprerjeje të parakohshme të kontratës së punës në shumë

prej 750.00 €, nga N.SH “NBI Rahovec” (në likuidim). Ankuesi ka pohuar se, kërkesa e tij është refuzuar pa bazë ligjore, sepse i njëjti pohon se ka dhuruar kontribut në ndërmarrje ku ka punuar për 15 vite. Ka shtuar se ai ka punuar në N.SH “NBI Rahovec deri në kohën kur atij i është ndërpre marrëdhënia e punës me njoftim të lëshuar nga AKM dt. 05 korrik 2006. Thekson se kërkesën e tij për dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së kontratës së punës me kohe e ka paraqitur tek AL. Ankuesi i ka propozuar Gjykatës, që ankesën e tij ta aprovoj si të bazuar. Ankuesi me ankese ka bashkangjitur: kopjen e vendimit të kundërshtuar, kopjen e Njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës të datës 05 korrik 2006, kopjen e letërnjoftimit dhe formularin për parashtrimin e kërkesës në likuidim.

Me 27 nëntor 2023, e paditura AKP-ja parashtrroi mbrojtje, në të cilën pohoi se AL ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. Ka theksuar se i kundërshton të gjitha pretendimet e ankuesit të paraqitura në ankesë duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj dhe si të tilla duhet të refuzohet. E paditura pohoi se ankuesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL në marrjen e vendimit. Po ashtu e paditura pohoi se kërkesa e ankuesit është e parashtruar në pajtim me nenin 36.2 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034. Më tej e paditura pohoi se një kërkesë monetare e çfarëdo lloji që një punëtor mund të ketë ndaj një punëdhënësi duhet të jetë paraqitur para ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent brenda periudhës tre vjeçare nga momenti kur N.SH-ja supozohet të mos i ketë përmbushur detyrimet e saj monetare ndaj parashtruesit. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i AL-së.

Në lidhje me detajet tjera, gjykata i referohet shkresave të lëndës dhe parashtrësive të palëve.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa aprovohet si e bazuar.

Ne bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësia apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuara), ndërsa, pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Sipas nenit 40.1.6.2 të shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i N.SH “NBI Rahoveci”. Në këtë çështje, kontestuese në mes palëve është fakti se ankuesi F M, a ka qenë punëtor aktiv i N.SH-së, kur u privatizua NSH “NBI Rahoveci”, në mënyrë që ti takojë e drejta në dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës. Ankuesi pretendon se ka qenë punëtorë deri në momentin e privatizimit të N.SH-së kur edhe i është lëshuara njoftimi nga AKM për ndërprerjeje të marrëdhënies së punës, ndërsa e paditura i kundërshton pretendimet e ankuesit duke pohuar se ankuesit nuk i takon e drejta e kompensimit, pasi që nuk është pushuar nga puna si rrjedhojë e ndonjë veprimi të ndërmarrë nga Agjencia siç parashihet në bazë të nenit 6.1 apo 6.2 të ligjit për AKP, dhe kështu nuk i takon e drejta në dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës. E paditura nuk e ka kontestuar lartësinë e shumës së kërkuar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në njoftimin e datës 05 korrik 2006, si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga njoftimi i datës 05 korrik 2006 e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte qenë punëtorë i N.SH “NBI Rahoveci”, deri në ditën e privatizimit dhe se me këtë letër ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon menjëherë si pasoje e shitjes së aseteve të N.SH-së.

Andaj, gjykata e pranon si provë relevante dhe të rregullt njoftimin e datës 05 korrik 2006, lëshuar nga vet Agjencia. Pra e paditura nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit iu kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të N.SH-së.

Me rastin e aprovimit të shumës prej 750.00 €, gjykata është nisur nga fakti se kjo shumë ishte kërkuar nga ankuesi edhe tek AL si dhe përmes ankesës të parashtruar pranë DHPGJS, dhe shuma nuk është kundërshtuar nga e paditura dhe si e tillë është aprovuar nga gjykata.

Pretendimi i të paditurës i ngritur në procedurë të ankesës se kërkesa e ankuesit është parashkruar brenda tre viteve nga momenti kur N.SH-ja supozohet të mos i ketë përmbushur detyrimet e saj, sipas Gjykatës nuk është i saktë, sepse ankuesit me dt. 05 korrik 2006, i ishte lëshuar njoftimi për ndërprerjen e punësimit dhe se atij ishte bërë me dije se pagat që u janë mbetur borxh mbesin përgjegjësi e punëdhënësit dhe ato do shqyrtohen kur të filloj procedura e likuidimit.

Gjykata vlerëson se, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 05 korrik 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurit, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje.

Nga kjo gjendje faktike e vërtetuar, gjykata vjen në përfundim se ankuesi F M, ishte punëtorë i N.SH “NBI Rahoveci”, në kohën e privatizimit të saj dhe se i takon e drejta në dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Në bazë të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë i bartë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, ankuesi është i liruar nga pagimi i taksës gjyqësore meqë vlera e kontestit nuk e kalon vlerën mbi 1000 €.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar